



REPUBLIKA E KOSOVËS
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHQIPTËRORE E KADASTRËS

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Agjencisë Kadastrale të Kosovës

dhe

Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të Republikës së Shqipërisë

për

**bashkëpunime në gjeodezi, kadastrë, hartografi, gjeoinformatikë,
teknologji informacioni dhe infrastrukturë të të dhënave hapësinore**

Me angazhimin për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë, në bazë të parimit të reciprocitetit nënshkruesit lidhin këtë marrëveshje:

Neni 1

Me këtë Memorandum, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës e Republikës së Shqipërisë (në tekstin në vijim: palët), përcaktojnë interesin e përbashkët për bashkëpunim në fushën e veprimtarisë bazë të kadastrës së pasurive të paluajtshme, vlerësimit të pasurive të paluajtshme, hartografisë, gjeodezisë, gjeoinformatikës, teknologjisë së informacionit dhe përcaktimit të infrastrukturës së të dhënave hapësinore.

Neni 2

Bashkëpunimi i Agjencive, në fushat e përcaktuara në Nenin 1 të këtij Memorandumi, përfshin:

- Shkëmbimin e ndërsjelltë të informacioneve shkencore dhe teknike, njohurive, eksperiencave dhe përvojave bashkëkohore, si në fushën e legjislacionit dhe atë të dixhitalizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
- Mbështetje për rritjen e kapaciteteve të personelit, shkëmbim i ndërsjelltë i grupeve të ekspertëve teknik dhe drejtues, me qëllim ofrimin e shërbimeve këshillimore dhe trajnuese, nëpërmjet programeve trajnuese profesionale për punonjësit e të dy agjencive, si në fushën juridike, hartografisë, gjeodezisë, gjeoinformatikes, teknologjisë së informacionit etj.
- Angazhimi dhe bashkëveprimi për ndërmarrjen e nismave ligjore për implementimin e reformave të vazhdueshme si në fushën e legjislacionit dhe të zbatimit praktik të tyre në regjistrimin e pasurive të paluajtshme, me qëllim përmirësimin e sistemit kadastral.
- Bashkëpunimi dhe koordinimi për zhvillimin e programeve të përbashkëta në funksion të gjetjes së mënyrave dhe burimeve që do ndikojnë drejtpërsëdrejti në përparimin dhe përshpejtimin e procedurave të punës ndërmjet hallkave të brendshme të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
- Përgatitjen dhe implementimin e projekteve rajonale me interes të përbashkët, me qëllim unifikimin dhe përmirësimin e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
- Harmonizimin e qëndrimeve dhe ekspozimin e përbashkët para organizatave profesionale ndërkombëtare, duke përfaqësuar interesin e përbashkët.
- Organizimin e përbashkët të takimeve, aktiviteteve, punëtorive dhe promovimin ndërkombëtar të programeve të përbashkëta për bashkëpunim në fushën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
- Aktivitete të tjera me interes të përbashkët për institucionet.

Neni 3

Palët ndihmojnë njëra-tjetrën dhe inkurajojnë realizimin e projekteve të përbashkëta në fushat e përcaktuara në Nenin 1 të këtij Memorandumi.

Neni 4

Me qëllim që të realizohet dhe shqyrtohet implementimi i këtij Memorandumi, propozimet e aktiviteteve të reja dhe dhënia e direktivave për implementimin e tyre, palët do të takohen një herë në vit, me radhë, në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Shqipërisë.

Në funksion të realizimit të këtij bashkëpunimi ndërmjet tyre, palët do të komunikojnë vazhdimisht edhe në formë të shkruar, ndërsa në raste urgjente edhe nëpërmjet mjeteve

të tjera të komunikimit elektronik.

-Nënshkruesit do të emërojnë edhe persona përgjegjës që do të ndjekin ecurinë e zbatimit të këtij memorandumi. Këta persona do të jenë në dispozicion në çdo rast për komunikim dhe koordinim të bashkëpunimit dhe do të raportojnë tek titullari përkatës.

Neni 5

Ky Memorandum nënshkruhet me afat 10(dhjetë) vjeçar.

Çdo nënshkrues, në çdo kohë mund ta ndërpresë Memorandumin, me anë të shkresës së dërguar palës tjetër, (6) gjashtë muaj më parë.

Ndërprerja e Memorandumit nuk ndikon në finalizimin e aktiviteteve të përcaktuara në bazë të Memorandumit dhe të filluara para ndërprerjes së tij, përveç rastit kur palët merren vesh ndryshe.

Neni 6

Ky Memorandum mund të ndryshohet dhe plotësohet pas diskutimeve dhe me pëlqimin me shkrim të të dy palëve.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje, në interpretim ose zbatim të këtij Memorandumi, palët e zgjidhin më konsulta dhe negociata të përbashkëta.

Neni 8

Ky Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

I nënshkruar në Prishtinë, datë __. __. 2019 në 4 kopje, në gjuhën shqipe, ku të katër tekstet janë identike.

Agjencia Kadastrale e Kosovës

DREJTOR EKZEKUTIV

AVNI AHMETI




REPUBLICA E KOSOVES
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES
PRISHTINEJA
REPUBLIKA KOSOVA

Agjencia Shtetërore e Kadastrës

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARTAN LAME



